REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me: Primljeno: | 09.12.2025 | |
|---|---|---|
| Njesia Jednica | Numri Broj | Shtojca Dodatak |
| 15-052/01-67223 | | |

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIK OF KOSOVO**

**KOMUNA E LIPJANIT**
**OPŠTINA LIPLJAN**
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

| | |
|---|---|
| Datë : | 09.12.2025 |
| Referencë : | |
| Për: | Daut Azemi – Kyesues i Kuvendit të Komunës se Lipjanit |
| Nëpërmjet : | Imri Ahmet- Kryetar i Komunës së Lipjanit |
| Nga: | Shemsi Azemi, Kordinator komunal për performancë në Komunën e Lipjanit |
| Lënda: | Raporti i performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2024 |

Sipas vendimit të Kryetarit të Komunës të datës 05.02.2025, nr 1Nr.016/01-6055 është themeluar komisioni për raportim në SMPK, i cili komision në afatit e parapar ka raportuar në MAPL për 16 fushat e SMPK.

SMPK (Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Komunave ) , bën matjen e performancës së komunave për 16 fusha të ndryshme themelore .

Komuna e Lipjanit ka shënuar një progres në raportin e SMPK, në nivel vendi me 80.00 %, ndërsa në radhitjen e Grandi i performancës nuk jemi kualifikuar për shkak të pasojave që në i ka sjell kontrata Kolektive.

Fushat themelore për të cilat bëhet matja e performancës së komunave në këtë rast edhe të Komunës sonë janë :



| | | |
|---|---|---|
| Lipjan | SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE | 98.82 |
| Lipjan | TRANSPARENCA KOMUNALE | 100.00 |
| Lipjan | PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE | 79.71 |
| Lipjan | BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE | 71.42 |
| Lipjan | KULTURË, RINI DHE SPORT | 100.00 |
| Lipjan | MENAXHIMI I FATKEQËSIVE | 65.00 |
| Lipjan | PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL | 98.92 |
| Lipjan | HAPËSIRAT PUBLIKE | 68.15 |
| Lipjan | INFRASTRUKTURA RRUGORE | 63.00 |
| Lipjan | TRANSPORTI PUBLIK | 60.54 |
| Lipjan | SHËRBIMET PUBLIKE | 98.69 |
| Lipjan | MBROJTJA E MJEDISIT | 89.39 |
| Lipjan | PËRFAQËSIMI GJINOR | 51.46 |
| Lipjan | ARSIMI PARAUNIVERSITAR | 57.46 |
| Lipjan | KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR | 98.29 |
| Lipjan | ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL | 86.21 |

Në vazhdim e paraqesim në përmbledhje të përgjithshme performancen e komunës sipas fushave te caktuara , në fushat ku përformanca është e lartë, e mesme dhe ku performanca është e ulët.

KOMUNA E LIPJANIT

Përmbledhje e përgjithshme

Performanca e përgjithshme e komunës në 16 fusha të matjes është 80.00%. Fusha me performancën më të lartë është, Transparenca Komunale me 100 % fusha Kulture Rini dhe sport me 100 %, Menagjimi i fatkeqësive me 100 , janë treguesve të përmbushur, derisa fusha e Infrastruktura rrugore me 63.00%. Performancë shumë e lartë është treguar edhe në fushën përgjegjshmërisë komunale me 79.71%, mbrojtja e mjedisit 89.39%, menaxhimi i fatkeqësive me 65%, shërbimet administrative me 98.82%, transporti publik 60.54%, Shërbimet Publike 98.69.% dhe fusha e kujdesit primar shëndetësorë me 98.29%. Fushat për të cilat duhet t'iu jepen prioritet janë: infrastruktura rrugore me 63.00%, e pasuar nga përfaqësimi gjinorë me 51.46%, Arsimi Parauniverzitar 57.46% .

Komuna ka respektuar kriteret për dokumentimin e të dhënave komunale të cilat janë në nivel të kënaqshëm të prezantimit të referencave të caktuara në formularët e raportimit brenda organeve komunale apo jashtë komunës nga ndërmarrjet publike komunale dhe institucionet tjera lokale. Po ashtu komuna e ka pambushur kriterin e raportimit për të gjithë treguesit e përformancës komunale.

PERFORMANCA SIPAS FUSHAVE

Fusha 1. Shërbimet Administrative

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 98.82%, apo 2.98% më e larte se në periudhën e njëjtë të vitit 2023, Komuna ka pranuar gjithsej 64521 kërkesa në procedurë administrative të parashtruara nga qytetarët, prej të cilave 61487 janë shqyrtuar apo 98.82%, kurse 3034 e kërkesave nuk janë shqyrtuar, apo kanë mbetur në proces të

shqyrtimit. Kërkesat e parashtruara për të cilat ka pasur proces të shqyrtimit administrativ, kanë përfunduar brenda afatit ligjor.

Ne menyre grafike :




Fusha 2. Transparenca komunale

Performanca e përgjithshme në fushën e transparencës është 100%. Që edhe në vitin 2024 ka qenë 100 %.

Komuna ka shënuar performancë të lartë prej 100% në treguesin, Mbledhjet e kuvendit të bëra publike dhe të transmetuara drejtpërdrejt online komuna ka performancë prej 100%, Niveli i qasjes në dokumente publike Performancë prej 100% Përmbushja e kritereve të faqes zyrtare elektronike të komunës 100%, Publikimi i akteve të miratuara në kuvendin komunal, në faqen zyrtare të komunës 100%, Publikimit i akteve me karakter të përgjithshëm, të miratuara nga kryetari i komunës, në faqen zyrtare të komunës 100%, Publikimi i dokumenteve për planifikim dhe shpenzim të buxhetit 100%, Publikimi i dokumenteve të prokurimit publik dhe i kontratave 100%. Komuna e Lipjanit ka dokumentuar të dhënat sipas udhëzimeve dhe kritereve të përcaktuara nga MPL.




Fusha 3. Përgjegjshmëria komunale

Performanca e përgjithshme në këtë fushë është 92.71% edhe në këtë fushë komuna ka raportuar performancë të lartë se performanca dhe reale. Gjatë fazës së verifikimit të dhënave të dhënat kanë qen të referuara mirë në dokumente burimore të paraqitura në dokumentin e raportimit nga ana e komunës dhe në referenca të caktuara nga ueb-faqja e komunës apo dokumente tjera.

Treguesi, Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e 2 takimeve publike ka performancë prej 100%, Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike 55.32%, Aktet komunale dhe dokumentet e politikave lokale të konsultuara me publikun 100%, dëgjime publike për KAB dhe buxhet komunal 100%, Publikimi i raporteve për procese të konsultimeve publike 100%, Këshillat lokal që kanë mbajtur së paku 6 takime në vit 100%, Diskutim për raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal për vitin paraprak 100%, Diskutimi i raportit të auditorit të jashtëm dhe planit të veprimit për adresim të rekomandimeve në Asamblenë Komunale 100%, Diskutimi i raportit të auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit në Asamblenë Komunale 100%, Mbledhje të Kuvendit me pjesëmarrje të kryetarit të komunës 100%, Niveli i zbatimit të planit të prokurimit 90.91%, Niveli i pagesave të procesuara brenda afatit ligjor prej 30 ditëve 99.73%, Niveli i adresimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditorit 58.33%, Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit para kuvendit komunal 100%, Suspendimi i zyrtarëve komunal në raport me akt-akuzat e ngritura ndaj tyre 100%, ,

Vlen të theksohet se komuna e Lipjanit në fushën 3 ka performancë të lartë gati në të gjithë treguesit dhe ka dokumentim të dhënave në nivel të kënaqshëm.




Fusha 4: Barazia në punësim, shërbimet sociale dhe familjare

Ndonëse fusha ka kaluar përmes procesit të riorganizimit të treguesve dhe rezultateve, krahasimi i performancës së treguesve në nivel të fushës rezulton me 71.42% . Familje me nevojë të cilave iu është siguruar banimi dhe janë krijuar kushtet për lëshim të banimit social 100.00%, Fëmijë me nevojë për strehim që iu është siguruar strehimi familjar 100%,




Fusha 5. Kulturë, Rini dhe Sport

Ndonëse fusha ka pasur riorganizmin në nivel të treguesve, krahasimi i performancës në nivel të fushës për Kulturë, Rini dhe Sport pasqyron lëvizje pozitive, ku për vitin e raportuar rezultati i arritur është 100%. Krahasimi me rezultatin e vitit 2023 ku përqindja ishte 100%,




Fusha 6. Menaxhimi i Fatkeqësive Natyrore

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 65%. Niveli i përgjithshëm i realizimit të planit Komunal për menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe të tjera është konstatuar të jetë 65%..




Fusha 7. Planifikimi Hapësinor

Komuna e Lipjanit  ka një territor prej 33864,0911 km2, apo 1022,8 ha, janë të mbuluara me plane rregulluese të hollësishme. Përqindja e arritur në këtë fushë është 98.92% .




Fusha 8: Hapësirat publike

Përqindja totale e arritur në këtë fushë është 68.15% dhe është shumë në nivel të njet sikurse vitin paraprak 2023




## Fusha 9. Infrastruktura Rrugore

Fusha e Infrastrukturës Rrugore ka pësuar ndryshime në aspektin e përmbajtjes së treguesve, mirëpo krahasimi i përformancës së arritur për vitin e raportuar 63.00 % me performancën e vitit 2024 tregon për një rritje të ndjeshme të përqindjes.



Fusha 10. Transporti Publik

Në fushën e Transportit Publik komuna e Lipjanit ka arritur performancë me 60.54%. Plani i veprimeve për transportin publik komunal ka paraparë 3 veprimtari, ku të gjitha 3 janë përmbushur, vlera e treguesit është 100%, kurse tek treguesi për përfshirjen e vendbanimeve në ofrimin e transportit publik është deklaruar nga 62 vendbanimet në nivel të komunës, 57 ose 91.9% janë të përfshira në transportin publik. Kurse sa i përket sigurimit të vendnalimeve të shenjëzuara, është raportuar për 37 prej 194 vendnalimeve që i ka komuna e Lipjanit.




Fusha 11. Shërbimet Publike

Fusha e shërbimeve publike shënon një rritje 98.69% nëse krahasohet me performancën e vitit 2023.




## Fusha 12. Mbrojtja e Mjedisit

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit komuna e Lipjanit ka shënuar një rritje të performancës, ku në vitin e raportimit ka arritur performancë prej 89.39% në raport me performancën e vitit paraprak




## Fusha 13. Përfaqësimi Gjinor

Është kjo fushë e re, e përbërë prej 3 rezultateve dhe 11 treguesve. Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 51.46%, ka nje ramje te performances në krahasim me vitin 2023.




Fusha 14. Arsimi Para universitar
Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 57.46%,.



Fusha 15. Kujdesi Primar Shëndetësor

Është kjo fushë e re, për herë të parë e zbatuar në raportimin e vitit 2023, e përbërë prej 3 rezultateve dhe 7 treguesve. Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 98.29%, paraqet një rritje në krahasim me vitin paraprak, dhe njikohsisht është më e larta në nivel vendi !




Fusha 16. Zhvillimi Ekonomik Lokal

Performanca e regjistruar në nivel të fushës është 86.21%. Plani për zhvillim ekonomik lokal është raportuar si i realizuar, me performancë prej 100%, komuna e ka azhurnuar dhe publikuar listën e pronave publike për dhënie në shfrytëzim me qëllim të mbështetjes së zhvillimit ekonomik, është përmbushur performanca prej 100%,

Filtro sipas vitit | Zgjedh fushën

2024 | ZHVILLIMI EKONOMIK ... | × Fshijë | Export










# Raporti përfundimtar I performances për viti 2024 Komuna Lipjan

Filtro sipas vitit | Zgjedh fushën

2024 | SHËRBIMET PUBLIKE A... | × Fshijë | Export







0%
25%
50%
75%
100%
TRANSPARENCA KOMUNALE
KULTURE, RINI DHE SPORT
100.0%
PLANIFIKIMI HAPSINOR KOMUNAL
SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE
SHËRBIMET PUBLIKE
KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR
MBROJTJA E MJEDISIT
ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL
PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE
BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE
HAPËSIRAT PUBLIKE
MENAXHIMI I FATKEQËSIVE
INFRASTRUKTURA RRUGORE
TRANSPORTI PUBLIK
ARSIMI PARAUNIVERSITAR
PËRFAQËSIMI GJINOR

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligji nr. 08/l-103 për sistemin e menaxhimit të performancës së komunave dhe skemën e grantit të bazuar në performancë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR EMËRIMIN E KOORDINATORIT KOMUNAL TË PERFORMANCËS DHE ZYRTARËVE KOMUNALË PËR PERFORMANCË PËR FUSHAT E CAKTUARA NË KOMUNËN E LIPJANIT PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË PERFORMANCËS PËR VITIN 2024

**Neni 1**
**Përbërja**

I.Me këtë Vendim, **SHEMSI AZEMI**, në pozicionin e punës Shef i sektorit për tatim në pronë, emërohet **Koordinator Komunal për performancë**, ndërsa **zyrtarë komunalë për** performancë për fushat e caktuara emërohen zyrtarët si vijon:

1. BURIM GASHI (fushën e shërbimeve publike administrative)
2. BUKURIJE ZEJNULLAHU ( fushën e transparences komunale dhe fushën e përgjegjshmërisë komunale)
3. ALBERT MUSTAFA ( fushën për të drejtat e njeriut, shërbime sociale dhe familjare)
4. RAMIZ GASHI (fushën e kulturës, rinisë dhe sportit)
5. GAFURR HETEMI ( fushën e menaxhimit të fatkeqësive)
6. HANUSHE BERISHA (fushën e planifikimit hapësinor komunal, fushën e hapësirave publike komunale dhe fushën e mbrojtjes së mjedisit)
7. FATBARDHA SHURDHIQI ( fushën e infrastrukturës rrugore lokale, fushën e furnizimit me ujë të pijshëm, fushën e kanalizimit dhe higjienës publike dhe fushën e menaxhimit të mbeturinave)
8. SALIHE MAREVCI ( fushën e transportit publik komunal dhe fushën e hapësirave për parkim publik )
9. HASAN LUMA ( fushën e përfaqësimit gjinor)
10. BRAHIM DURIQI (fushën e arsimit parauniversitar)
11. IZER SINANI (fushën e kujdesit primar shëndetësor)
12. LINDA SHAHINI (fushën e integrimit dhe zhvillimit)

- Bashkërendon dhe bashkëpunon me përgjegjësitë e njësisë përkatëse ku punon dhe prej ku i merr të dhënat dhe me KKP.
- Raporton të dhënat e verifikuara tek KKP, në kopje fizike, kur kjo nuk bëhet në mënyrë automatike nga program elektronik i SMPK. Është përgjegjësi kryesor për saktësinë e të dhënave të raportuara në komunë për SMPK.

**Neni 4**
**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet MAPL, Koordinatori komunal për performancë dhe zyrtarët komunal për performancë të cekur më lartë.

Nr. 016/01-6055
Lipjan, më 05.02.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti